



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:103011

Datë: 15.01.2021

Numri i dokumentit: 01411716

**C.nr.831/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Naim Mehollli dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të paditësit I.S nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.T, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës K... të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A.M, për shkak të kompensimit në emër të ushqimit në punë në shumë totale prej 1,088.00 euro, gjykata pas mbajtjes së seancës kryesore publike në prezencë të të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësuesit të të paditurës, me datë 15.01.2021, jashtë seancës nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit I.S nga Mitrovica, ashtu që:

**II. OBLIGOHET** e paditura K... që në emër të kompensimit për ushqimin për praninë në punë për periudhën kohore 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020, për ditët totale të pranisë në punë prej **544 ditë** dhe atë (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) paditësit I.S nga Mitrovica, t'ia paguajë shumën totale prej **1,088.00 euro** (njëmijë e tetëdhjetë e tetë euro), duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e gjer në përmbushjen përfundimtare të detyrimit, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

**III. OBLIGOHET** e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit t'ia paguajë shumën totale prej 269 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi I.S nga Mitrovica, përmes të autorizuarit të tij avokat L.T, më datë 25.09.2020 ka ushtruar padi kundër të paditurës K..., të cilën në seancën e datës 13.01.2021 e ka bërë zgjerimin e padisë, duke kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të pranisë në punë (për secilin ditë të pranisë në punë nga dy euro) dhe atë për periudhën 18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020, ka kërkuar shumën totale prej 1,088.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës, kurse ka hequr dorë nga kamata ligjore.

Gjykata me datë 13.01.2021, ka caktuar seancë gjyqësore, në të cilën kanë prezantuar i autorizuari i paditësit avokati L.T dhe përfaqësuesi i të paditurës A.M.

Në seancën për shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, por bënë zgjerimin dhe precizimin e padisë, përkatësisht ka kërkuar që paditësi të kompenzohet për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 18.04.2017 e gjerë me 11.03.2020, për 544 ditë pune apo shumë prej 1,088.00 euro, gjë për të cilën gjykatës dhe palës së paditur i'a dorëzon kopjen e vërtetimit për ditët e pranisë në punë në emër të paditësit, konsideron se padia është e bazuar dhe e mbështetur në prova dhe si të tillë gjykatës i propozon që ta aprovoj në tërësi, shpenzimet e procedurës i kërkon dhe atë si në vijim për përpilim të padisë shumë prej 104 euro, për seancë gjyqësore shumë prej 135 euro dhe taksën gjyqësore prej 30 euro, ka hequr dorë nga kamata ligjore, e tërhek vërtetimin e mëhershëm të përvojës së punës ndërsa propozon që për bazë të merret vetëm vërtetimi i dorëzuar sot në këtë seancë.

Në seancën për shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës Avdi Muzliukaj e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, këtë kundërshtim e ka bazuar në dispozitat territoriale të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 18.04.2017. Nuk e konteston faktin se paditësi është i punësuar te e paditura e as ditët e vijueshmërisë në punë, nuk e kundërshton as zgjerimin e padisë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kopja e letërnjoftimit për paditësin; Kërkesa drejtuar të paditurës dt.01.11.2019, Kontrata e Punës e datës 22.05.2018; Vërtetimi i lëshuar nga Shkolla SH.F.M.U. “...” i datës 25.09.2020 me nr. tëpr.70/2019, dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje.

Fillimisht paditësi para ngritjes se padisë me datë 01.11.2019 ju ka drejtuar te paditurës me kërkesë për kompensimin për ushqim për ditët e pranisë në punë, të cilën kërkesë e paditura e ka pranuar me po të njëjtën datë 01.11.2019, mirëpo e paditura nuk ka kthyer përgjigje.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura si Mësimdhënës në shkollën SH.F.M.U. “...” në vitet shkollore 2017/2018 dhe 2018/2019 dhe 2019/2020 (vite këto për të cilat paditësi kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe atë nga data 18.04.2017 deri 11.03.2020), ky fakt u vërtetua nga këto prova: vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U. “...” me nr. të protokollit 70/2019 i datës 25.09.2020, si dhe nga Kontrata e punës e datës 22.05.2018.

Gjykata, nga provat në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura, gjegjësisht drejtori i shkollës SH.F.M.U. “...” dhe atë vërtetimi i datës 25.09.2020 me nr. pr. 70/2019 është vërtetuar se paditësi që nga data 18.04.2017 e gjer me datën 11.03.2020 te e paditura ka pas ditë të pranisë në punë sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të cilat iu është aprovuar shuma nga 2 euro për çdo dite të pranisë në punë.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës II të dispozitivit, iu referua, nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në të cilin parashihet *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjate punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit për një dite të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*. Prandaj, mbi këtë bazë, gjykata konstatoi se punëdhënësi i paditësve është pikërisht e paditura

me çka vërtetohet edhe nga kontratat e punës që gjenden në shkresat e lëndës, andaj raporti juridik i paditësit me të paditurën të njëjtën e bën legjitime dhe me detyrim për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, po ashtu me rastin e vendosjes pati parasysh edhe nenin 90, par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, në të cilën parashihet *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, ndërsa në nenet e përcaktuara të lartë cituara është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret të paditurës për kompensimin e ushqimit në punë edhe pse të njëjtë nuk janë nënshkruar të kontratës kolektive të arsimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtor që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësin.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, për përfaqësim për një seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, në emër të përpilimit të padis 104 euro dhe 30 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe kundërshtimet e përfaqësuesit ligjor të të paditurës se dispozitat kalimtare të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka paraparë që lidhur me implikimet financiare sa i përket çështjes së transportit dhe ushqimit duhet të themelohet një komision i përbashkët i sindikatës e i cili gjatë hartimit të projekt buxhetit shtetëror parashih edhe këto implikime financiare mirëpo deri me sot asnjë përfaqësues i SBASHK-ut nuk ka qenë prezent në këtë komision qeveritar për të propozuar saktë koston financiare të implikimit buxhetor lidhur me çështjen e transportit dhe ushqimit të punëtorëve të sektorit të arsimit në RKS, mirëpo gjykata këto pretendime i refuzoi si të pa bazuara për arsye se paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin buxhetor për obligimet që dalin nga kontrata e lartcekur. Përveç kësaj dispozita e nenit 46 të kësaj kontrate ka karakter udhëzues e jo imperativ apo detyrës, dhe se nuk është bazë juridike për refuzimin e kërkesëpadisë.

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.831/2020, datë 15.01.2021**

**GJYQTARI,**  
Naim Mehulli

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.